



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjena/Pridata Received/Delivery	12.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	4218/2023		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.626/2023

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në lidhje me ankesën A.nr.626/2023 të datës 07.04.2023 të parashtruar nga ankuesit _____ të cilët i përfaqëson ankuesi _____ kundër organit të punësimit/ Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 12.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.626/2023 të datës 07.04.2023 të parashtruar nga ankuesit _____

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 04.07.2022 përmes kërkesës ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës të nxjerr Vendim për kompensimin e shtesës mbi pagën bazë për shkak të rrezikshmërisë në vlerën prej 205 Euro. Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës më datë 06.07.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 26/2022, përmes të cilit është vendosur që të lejohet shtesa për rrezikshmëri për ankuesit në shumën prej 205 Euro.

Me datë 06.07.2022 Menaxheri i Personelit i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka përcjell në Thesarin e Kosovës formularët për kompensim sipas vendimit të cekur më lartë, ndërsa Zëvendës

Drejtori i Përgjithshëm për Administratë dhe TI i Thesarit të Kosovës përmes emailit të datës 20.07.2022 ka njoftuar Menaxherin e Personelit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës se a ka ndonjë vendim nga Kuvendi i Kosovës sipas të cilit është lejuar shtesa për rrezikshmëri... dhe keni parasysh se cili institucion ka drejte në nxjerrjen e vendimit për shkresa të caktuara për shërbyesit publik apo civil, kështu që nuk do të procedohen këto shtesa derisa të sqarohet baza ligjit, mirëpo më datë 20.07.2022 Menaxheri i Personelit i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës ka përcjell tërë dokumentacionin që posedojnë ndërsa Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm për Administratë dhe TI i Thesarit të Kosovës përmes emailit të datës 20.07.2022 ka njoftuar se për lejimin e shtesave të rrezikshmërisë për shërbyesit civil duhet të keni vendim nga Kuvendi.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës më datë 09.08.2022 ka dërguar kërkesë me Nr. Port: 214/2-06/D tek Kryetari i Komisionit për buxhet, Punë dhe Transfere të Kuvendit të Republikës së Kosovës duke kërkuar që të mbështet kjo kërkesë, mirëpo nuk kanë marr përgjigje.

Ankuesit të punësuar në Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, më datë 07.04.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 3390/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar kompensimin në vlerën prej pesëmijë e nëntëqind e tetëdhjetegjashtë euro (5,986.00 Euro) për të gjithë ankuesit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.04.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesve tek Autoriteti Kosovar i Konkurrencës. Ndërsa Këshilli më datë 26.04.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3390/2023 të datës 07.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin PCF-2 për planifikim për vitin 2023 dhe 2022; Listë e buxhetit e vitit 2023; Kërkesën me Nr. Port: 214/22-06/D e datës 09.08.2022 nga Drejtori i Përgjithshëm i sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për Kryetarin e Komisionit për buxhet, Punë dhe Transfere të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Shkresë për disponueshmëri të mjeteve financiare për pagesë shtesë për rrezikshmëri e datës 06.07.2022 për Udhëheqësin e Divizionit të Pagave në MFPT; Vendimin me Nr. 26/22 të datës 06.07.2022; Organogrami i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës; Procesverbalin e mbledhjes së komisionit për buxhet dhe financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës i datës 30.11.2012, 27.12.2018; Emailin e datës 06.07.2022 nga [] për []; Emailin e datës 20.07.2022 nga [] për []; Emailin e datës 20.07.2022 nga [] për []; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3660/2023 të datës 18.04.2023; Akt Emërimin e datës 27.03.2013 për ankuesin []; Akt Emërimin e datës 01.10.2019 për ankuesen []; Akt Emërimin e datës 08.09.2016 për ankuesin []; Akt Emetimin e datës 01.10.2019 për ankuesen []; Vendimin me Nr. 16/19 të datës 01.04.2019; Kërkesën për

pagesën e shtesës për rrezikshmëri e datës 04.07.2022; Formuarin e të dhënave në listën e pagave për ankuesit i datës 06.07.2022; Listën e pagave për periudhën janar-qershor 2022 për ankuesit;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankuesve është e pa pranueshme, *sepse*:

Nga provat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës më datë 09.08.2022 përmes kërkesës me Nr. Prot: 214/2-06/D ka kërkuar nga Kryetari i Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere të Kuvendit të Republikës së Kosovës për të mbështetur kërkesën për shtesë për rrezikshmëri për nëpunësit civil të Sekretariatit të Autoritetit Kosovar të konkurrencës, mirëpo lidhur me këtë çështje nuk kanë marr përgjigje, në këtë rast Kolegji i Këshillit konstaton se në rast kur me ligj të veçantë nuk është paraparë ndonjë afat për përfundimin e procedurë administrative, atëherë janë të aplikueshme dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj*", rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, vlerëson se në momentin kur ankuesit nuk kanë marr përgjigje ndaj kërkesës së datës 09.08.2022 brenda afateve të përcaktuara si më lartë, atëherë ankuesit kanë pasur të drejtë të fillojnë procedimin administrativ për heshtje administrative.

Lidhur me fillimin e procedimit administrativ ndaj heshtjes administrative, Kolegji i Këshillit i'u referuar nenit 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ..."* rrjedhimisht mbi këtë bazë ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankesa e ankuesve e datës 07.04.2023 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e pasafatshme, sepse ankuesit procedimin administrativ kundër heshtjes administrative është dashur ta fillojnë brenda afateve të përcaktuar me dispozitat e sipër cekura, andaj, mbi këtë bazë tw asaj qw u tha si mw lartw ,Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesve është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji"*.

Andaj, duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej

tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.626/2023, datë 12/05/2023.

Avdyll BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit/Përfaqësuesit të ankuesve,
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

